



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**MBI KONSULTIMIN PUBLIK PËR HARTIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË
PYJEVE.**

I mbajtur më 13.08.2025, në orën 13:00, në dëgjese me banorë të Njesis Administrative Paskuqan, në lidhje me propozimin mbi miratimin e Planit të Mbarështimit të Sipërfaqeve Pyjore.

Takimi u zhvillua në Njësia Administrative Paskuqan.

Të pranishëm në takim ishin:

- Administratori i Njesisë Administrative Paskuqan, z.Eduart Bodini
- Përfaqësues të Drejtorisë së Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave dhe Menaxhimit dhe Administrimit të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve
- Përfaqësues të Këshillit Bashkiak
- Ndërlidhës me Komunitetin
- Shoqëri Civile
- Banorë të Zonës

Takimi u hap me prezantimin e planit nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Kamëz, ku u theksua se ky plan është hartuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me nr.6413 prot., datë 23.07.2025, të lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Fakultetit të Shkencave Pyjore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Sipërfaqet pyjore për të cilat është hartuar Plani i Mbarështimit janë transferuar në pronësi të Bashkisë Kamëz me VKM-në nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave për transferimin në pronësi të bashkive, të

pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit, e të ish-komunave/bashkive” dhe janë certifikuar në emër të Bashkisë Kamëz në vitin 2025.

1. Qëllimi i hartimit të Planit të Mbarështimit

Gjatë prezantimit nga specialistët e Bashkisë Kamëz, u sqarua se qëllimi kryesor i hartimit të Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështim të qëndrueshëm dhe funksional të pyjeve dhe kullotave bashkiake brenda kufijve të Ekonomisë Pyjore (EP) të Bashkisë Kamëz për periudhën 2025-2035, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike, konkretisht për sipërfaqet e mëposhtme:

- a) Pasuria nr.1444/1, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 15302 m².
- b) Pasuria nr.1444/2, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 213244 m².
- c) Pasuria nr.1444/5, zk.1066, e llojit “Pyll”, me sipërfaqe 1311745 m².

Në këtë drejtim PMPK synon të përcaktojë, përmes një qasje të integruar , pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullimore dhe nevojat bashkiake e të palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre.

2. Sqarimi i procedurës së ndjekur për hartimin e Planit të Mbarështimit dhe përgjegjësitë

Përgatitja e Planit të Mbarështimit është marrë përsipër nga Fakulteti i Shkencave Pyjore. Puna ka filluar me grumbullimin e dokumentave të nevojshme për hartimin e planit të mbarështimit si:

- Planin e vjetër të inventarizimit, hartat e ekonomisë pyjore
- Studimet e mëparshme si Plani I Zhvillimit Vendor të Bashkisë Kamëz, Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2023, si dhe ligji nr.57/2020 “Për pyjet”.
- Udhëzuesi i planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019

Pas prezantimit të arsytimit nga përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz, u theksua se ky plan është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet si me ligji nr.57/2020 “Për pyjet” dhe me Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Urdhrin nr.864 prot, datë 30.01.2019.

Me shumicën e të pranishmëve dhe pa kundërshtime, banorët shprehin dakordësinë për miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve nga Këshilli Bashkiak Kamëz dhe dërgimin e tij për miratim tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Ky procesverbal do t'i bashkëngjitet dokumentacionit përkatës që do t'i përcillet për miratim Këshillit Bashkiak Kamëz dhe më pas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit sipas përcaktimeve të nenit 11 pika 2/b, e ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”.